



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
KËSHILLI DREJTUES

VENDIM

Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë, mbledhur në datë 10.10.2022, ora 11:30, në prezencë të anëtarëve të tij, në mbështetje të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbaues gjyqësor privat”, dhe nenit 7 të urdhrit nr. 364, datë 31.5.2021 të ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e “Programit të detyrueshëm për trajnimin fillestar””, duke mbajtur në konsideratë përvojën profesionale dhe trajnimit të secilit përmbaues gjyqësor aktiv, sipas rendit të ditës, me votim unanim të anëtarëve të tij,

VENDOSI:

1. Të emërohen si anëtarë të Komisionit të Kualifikimit për organizimin e provimit të pranimit në trajnimin fillestar:
 - a) **Z. Alban Ruli** përmbaues gjyqësor privat, anëtar aktiv i Dhomës Kombëtare;
 - b) **Z. Fabio Isufaj** përmbaues gjyqësor privat, anëtar aktiv i Dhomës Kombëtare.
2. Me qëllimin marrjen e masave për organizimin në kohë të provimit të parë të pranimit në Programin e Trajnimit Fillestar pranë Qendrës Kombëtare të Trajnimit të Përmbauesve për vitin 2022, data e të cilit është caktuar me vendim të Këshillit Drejtues, Kryetari i Dhomës ngarkohet të mbajë komunikimet institucionale me Ministrinë e Drejtësisë dhe Shkollën e Magjistraturës, me qëllim caktimin nga ana e tyre të anëtarëve respektivë në Komisionin e Kualifikimit.
3. Me plotësimin dhe konstituimin e Komisionit të Kualifikimit me anëtarët përkatës, ky Komision të mbështetet nga znj. Blerina Hoxhaj, në cilësinë e sekretares, punonjëse e Dhomës Kombëtare me detyrë asistente administrative.
4. Masa e shpërblimit të anëtarëve të Komisionit dhe e sekretarit që do ta asistojë të përcaktohet në konsultim me ministrin e Drejtësisë dhe sipas përcaktimit të tij, masa e shpërblimit për mbledhje, të përballohet nga buxheti i Dhomës Kombëtare.
5. Komunikimet e nevojshme institucionale me qëllim zbatimin e këtij vendimi, të mbahen nga Kryetari i Dhomës, i cili mban detyrën e Drejtorit Ekzekutiv të Qendrës Kombëtare të Trajnimit të Përmbauesve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë!

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES

Z. Alban RULI

Znj. Najada BEQARAJ

Z. Admir BEQIRI

Z. Ilia ELEZI

Z. Fabio ISUFAJ

Z. Bislim SINAJ

Z. Ilir DERVISHAJ